

20101162243

L I G J PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MUZE

Neni 1

Në Ligjin për muze ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 66/2004 dhe 89/2008), neni 45 ndryshohet si vijon:

„(1) Gjorbë në shumë prej 500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

- në afatin e përcaktuar profesionalisht nuk e përpunon materialin muzeor (neni 20 paragrafi (1),

- nuk kryen revizion të sendeve muzeore (neni 21),

- publikisht nuk i thekson ditët dhe orët për vizitë dhe nuk përcakton çmime të zvogëluara për llojin e caktuar të vizitorëve (neni 25 paragrafët (2), (3) dhe (4)),

- nuk e përcakton kopjen muzeore me shenjë se bëhet fjalë për kopje (neni 27 paragrafi (2)) dhe

- nuk mban regjistër të kopjeve muzeore (neni 27 paragrafi (6)).

(2) Gjorbë në shumë prej 300 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) alineja 4 e këtij neni, personit juridik mund t'i shqiptohet masë e veçantë për kundërvajtje, konfiskim i sendeve të cilat janë fituar me kryerjen e kundërvajtjes.

Neni 2

Pas nenit 45 shtohen tri nene të reja neni 45-a, 45-b dhe 45-v, si vijojnë:

"Neni 45-a

(1) Gjorbë në shumë prej 1 000 deri në 1 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

- kryen veprimtari muzeore pa aktvendim se i plotëson kushtet për fillimin e punës në muze (neni 7),

- nuk mban libër hyrës, libër të inventarit, libër dalës dhe lloje tjera të evidencës (neni 20 paragrafët (1) dhe (2)),

- për një send muzeor përpunon më shumë se pesë kopje (neni 27 paragrafi (4));

- përdor kopje muzeore për qëllime komerciale (neni 27 paragrafi (5)) dhe

- përpunon kopje me qëllim komercial dhe riprodhon sende muzeore pa pëlqimin e muzeut (neni 28).

(2) Gjorbë në shumë prej 700 deri në 1 000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjorbë në shumë prej 600 deri në 700 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) alineja 5 të këtij neni, personit fizik.

(4) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) alinetë 3, 4 dhe 5 të këtij neni, personit juridik mund t'i shqiptohet masë e veçantë për kundërvajtje konfiskim i sendeve të cilat janë fituar me kryerjen e kundërvajtjes.

(5) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) alineja 5 të këtij neni, personit fizik mund t'i shqiptohet masë e veçantë për kundërvajtje, konfiskim i sendeve të cilat janë fituar me kryerjen e kundërvajtjes.

Neni 45-b

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori i kulturës konstaton se është kryer parregullsi e cila në pajtim me këtë ligj është përcaktuar si kundërvajtje nga neni 45 i këtij ligji, inspektori i kulturës është i detyruar që të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsinë e kryer me sugjerim për mënjanimin e parregullsisë së konstatuar në afatin e caktuar dhe me dorëzim njëkohësisht të ftesës për realizimin e edukimit të personit ose subjektit, ku është konstatuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e realizimit të edukimit, i përcakton ministri i Kulturës.

(3) Edukimin e organizon dhe e realizon Ministria e Kulturës, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(4) Edukimi mund të realizohet për më shumë parregullsi të konstatuara të njëjta ose të njëllojta për një ose më shumë subjekte.

(5) Nëse në terminin e caktuar personi ose subjekti për të cilin realizohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është realizuar.

(6) Nëse personi ose subjekti për të cilin realizohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe e kryen, do të konsiderohet se është edukuar lidhur me parregullsinë e konstatuar.

(7) Nëse inspektori i kulturës gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se janë mënjeluar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton konkluzion me të cilin e ndërpret procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

(8) Nëse inspektori i kulturës gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se nuk janë mënjeluar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtron kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para organit kompetent.

(9) Ministria e Kulturës mban evidencë për edukimin e realizuar në mënyrën e përcaktuar nga ministri i Kulturës.

Neni 45-v

Ministria e Kulturës për kontrollet e kryera nga ana e inspektorëve të kulturës përgatit raporte tremujore të cilat publikohen në ueb faqen e Ministrisë së Kulturës për shqyrtim të unifikuar tremujor."

Neni 3

Në nenin 45-a i cili bëhet neni 45-g, paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 45 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje udhëheq dhe sanksion për kundërvajtje shqipton organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e kulturës (në tekstin e mëtejme: Organi për kundërvajtje), ndërsa për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 45-a të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje udhëheq dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente."

Neni 4

Në nenin 45-b i cili bëhet neni 45-d paragrafi (1), pas numrit "45" shtohen fjalët: "dhe 45-a".

Në paragrafin (2) fjalët: "Kur kryerësi i kundërvajtjes është pajtuar për ngritjen e procedurës për barazim" shlyhen, ndërsa fjala "inspektori" zëvendësohet me fjalën "Inspektori".

Në paragrafin (4) fjala "mund" shlyhet.

Paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

"Konsiderohet se kryerësi i kundërvajtjes me nënshkrimin e pranimit të urdhërpagesës, pajtohet që ta paguajë gjobën".

Neni 5

Aktet nënligjore të cilat parashihen me këtë ligj, do të miratohen në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".